



FILLOI FUSHATA E STREHIMIT FAMILJAR NGA ORGANIZATA AMICI DEI BAMBINI

Amici dei Bambini mbështet Qendrat për punë sociale rreth STREHIMIT FAMILJAR me projektin Kosovë AID 9497 **“Forcimi i shërbimeve për motive familjare, në favor të fëmijëve në Qendrat për Punë Sociale në Kosovë”**. Ky projekt është duke u implementuar në 38 Qendra Për Punë Sociale në terë territorin e Kosovës.

Organizata Amici dei Bambini është në marrëveshje bashkëpunimi përveç tre ministrive (MPMS/DMS; MASHT dhe MSH) edhe me Asociacionin e Komunave të Kosovës në bashkëpunim të mirë me Kolegjin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Të gjithë drejtorët e Drejtorive të Shëndetësisë dhe të Mirëqenies Sociale në të gjitha Komunitetet e Kosovës kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm, duke e përkrahur këtë formë të mbrojtjes së fëmijëve në vështirësi, si kategori me prioritet, në lidhje mundësinë e rritjes së fëmijëve në ambient familjar.

Në kuadër të aktiviteteve të Amici dei Bambinit në këtë periudhë është duke u realizuar një FUSHATË SENSIBILIZUESE në media (Gazeta, Radio, TV dhe mini- webfaqe në internet) rreth STREHIMIT FAMILJAR.

Qëllimi i kësaj fushate është që të afrohen dhe lajmërohen familjet Kosovare rreth mirëpritjes së përkohshme të fëmijëve jashtë familjes. Qëndrimi i tyre në periudhën e pritjes deri sa të bëhet zgjedhja e statusit të tyre nga shërbimet sociale, fëmiju qëndron në një familje të përkohshme ku edhe socializohet dhe rritet në ambient familjar.

Në dispozicion e kanë numrin e telefonit ku mund të telefonojnë gratis dhe mund të marrin informata me të hollësishme 0 800 11888.

Ju mund të qaseni në linkun www.strehimifamiljar.org ku mund të kuptoni më për së afërmi çfarë është strehimi familjar dhe ku mund të merren informatat më të hollësishme.

Një mirëpritje e fëmijëve në vështirësi, një mundësi zhvillimi në ambient familjar deri në zgjedhje të statusit të tij.



Ref: AID 9497/AIBI/KOS Rafforzamento dei servizi in favore dei minori in carico ai centres of social work del Kosovo per motivi familiari

Ai.Bi. Amici dei Bambini
Lakrishte Lok 3-1 Sol 1
Pristina – KOSOVO
Tel. (00381) 38 613 888 – pristina@aibi.it